



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 741 Prot.

Tiranë, më datë 19.05.2021

**VENDIM**  
**Nr. 261, datë 19.05.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.05.2021:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e relacionit të verifikimit në terren të gjetjeve arkeologjike (Shpella e Ftohtë), në fshatin Gjuras, Bashkia Bulqizë, realizuar nga IKTK/DSHA;
2. Kryerjen e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor përreth zonës së “Shpellës së Ftohtë” nga IKTK dhe DRTK Shkodër, veçanërisht në hapësirën me toponimin “Kodra e Gjytezës”, e cila gjendet fare pranë shpellës, me qëllim identifikimin e potencialit arkeologjik përreth;
3. Marrjen e disa kampionëve nga skeletët që gjenden brenda shpellës, me qëllim kryerjen e analizave, si dhe datimin e tyre, të cilat mund të realizohen në laboratorë/ institucione të specializuara jashtë vendit, përmes akt-marrëveshjeve përkatëse konform legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore;
4. Pas kryerjes së vëzhgimit arkeologjik për verifikimin e potencialit dhe kryerjes së analizave për skeletet, ekipi i specialistëve të ngarkuar për realizimin e kësaj detyre të përgatisë një relacion të detajuar me qëllim vijimin e procedurave për shpalljen e kësaj shpelle pasuri kulturore, në përputhje me nenin 50 pika 1 e ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Arta DOLLANI**

